

**URDHËR**  
**Nr.190, datë 19.3.2020**

**PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË INSTITUCIONEVE ARSIMORE  
PUBLIKE DHE JOPUBLIKE DHE ÇERDHEVE PËR KUFIZIMIN E PËRHAPJES  
SË INFEKSIONIT COVID-2019**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 4, gërma “a”, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, si edhe udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-2019,

**URDHËROJ:**

1. Mbylljen e institucioneve arsimore publike dhe jopublike dhe çerdheve deri në datën 3.4.2020.

2. Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 153/1, datë 9.3.2020 “Për mbylljen e veprimtarisë së çerdheve për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19” dhe urdhri nr.135 datë 9.3.2020 “Për mbylljen e institucioneve arsimore për kufizimin e përhapjes së infeksionit COVID-19”, shfuqizohen.

3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet e qeverisjes vendore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË  
DHE MBROJTJES SOCIALE  
Ogerta Manastirliu**